



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHERBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Godina ish-hotel "Drini", Tiranë,

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 262 prot.

Tiranë, më 07.04.2017

V E N D I M

Nr. 76, datë 07.04.2017

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ
filluar me urdhrin nr. 748/1, datë 11.01.2017**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 79-90, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit të protokolluar pranë Komisionerit me nr. 748 prot., datë 15.12.2016, për disa pretendime të ngritura në lidhje me procedurën e transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për punonjësin *****,

VËREJ SE:

Pas njohjes me informacionin që përmbante kërkesa e parashtruar prej nëpunësit ***** me urdhrin nr. 748/1 prot., datë 11.01.2017, të Komisionerit ka nisur verifikimi paraprak i çështjes, në përfundim të të cilit, rezultoi sa më poshtë:

Nëpunësi ***** ka qenë i emëruar në pozicionin "Inspektor i Parë", në Sektorin e Tatimeve Indirekte, në Drejtorinë Teknike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kategoria e pagës III-b.

Rezulton se, me urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore" është miratuar struktura e re organizative dhe funksionale e administratës tatimore qendrore. Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me urdhrin nr. 158, datë

20.09.2016, “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, ka vendosur ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, i cili më tej me urdhrin nr. 158/1, datë 10.10.2016, të DAP, ka ndryshuar përbërjen e tij.

Në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, Komisioni i Ristrukturimit ka përgatitur propozimin me shkrim për transferimin e nëpunësve civilë, vendet e të cilëve prekeshin për shkak të ristrukturimit. Rezulton se, për punonjësin ***** Komisioni i Ristrukturimit ka propozuar transferimin e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, nga pozicioni “Inspektor i Parë”, në Sektorin e Tatimeve Indirekte, në Drejtorinë Teknike, **me kategori page III-b**, në pozicionin e punës “Specialist”, në Sektorin Teknik, në Drejtorinë Ligjore dhe Teknike, **me kategori page IV-a**.

Në zbatim të pikës 20, të aktit nënligjor të sipërcituar, njësia përgjegjëse, me aktin nr. 6887/78, datë 10.11.2016, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, ka vendosur transferimin e përhershëm të nëpunësit ***** në pozicionin e sipërpërmendur, për të cilin ky nëpunës është njoftuar në datën 14.11.2016 dhe nuk ka qenë dakord.

Ndërkohë, Komisioneri konstaton se, ankuesi ***** i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, fakt që materializohet në informacionin e sjellë me shkresën nr. 248/1 prot., datë 26.01.2017, “Kthim përgjigje”, nga Departamenti i Administratës Publike dhe kërkesëpadinë me objekt, si më poshtë:

- “Shfuqizimi i aktit administrativ vendimi nr. 1011, datë 21.11.2016, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për emërimin e ***** si specialist, kategoria IV-a.
- Shfuqizimi i aktit administrativ të Departamentit të Administratës Publike nr. 6887/78, datë 10.11.2016,
- Detyrimin e palës së paditur të bëjë kthimin në kategorinë e mëparshme të ***** si “Inspektor i Parë”, kategoria III-b dhe pagesën në bazë të kësaj kategorie deri në sistemimin në kategorinë III-b”.

Në këto rrethana, në kushtet kur sipas përcaktimit të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku sanksionohet parimi themelor i mos shqyrtimit nga institucionet e tjera të çështjeve që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor dhe sipas parashikimeve të nenit 41, pika 3, e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku përcaktohet e drejta e nëpunësit civil për t’u ankuar në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi që cenon të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme, në marrëdhëniet e shërbimit civil, Komisioneri vlerëson se problemi do të marrë zgjidhje përfundimtare nga gjykata dhe për këtë shkak hetimi administrativ duhet të përfundojë.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2-13, “Për nëpunësin civil”, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 16 dhe 34, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procedimit administrativ përcjellë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me shkresën nr. 748 prot, datë 15.12.2016.
2. Të njoftohet për këtë vendim Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Departamenti i Administratës Publike dhe kërkuesi *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA